



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 5612 / 11 prot.

MINISTRI

Tiranë, më 21/12/2020

URDHËR

Nr. 682, datë 21.12.2020

PËR

NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E  
MADHE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "a" të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 5612 datë 21.12.2020,

U R D H Ë R O J:

1. Pezullimin e transportit ajror të pasagjerëve me Britaninë e Madhe duke filluar nga ora 06:00 datë 22.12.2020 deri në datë 06.01.2021.
2. Vetëkarantinimin e detyrueshëm për një periudhë 14 ditore për të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare, dhe kanë nisur udhëtimin e tyre nga Britania e Madhe.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor si dhe organet e tjera sipas Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid19", i ndryshuar.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

